



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 21/04/2026 **Ora :** 10:00

Vendi: Fshati Vërrri (Njësia Administrative Proptisht)

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 14 persona të pranishëm

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : “Për miratimin e dhënies me qira, për vendosjen e antenave të telefonisë të lëvishme në favor të kompanive One Albania SH.A në sipërfaqe, 160 M2 në pasurinë 665 ZK 2042 Kalivaç, Trebinjë dhe Vodafon Albania SH.A sipërfaqen 100 M2 në pasurinë 213/6 ZK 3753 Vërrri Proptisht”

Pjesëmarrës :

Klajdi Gjona (Këshilltar)

Vjollca Pllaha (Këshilltare)

Besnik Xhyra (Këshilltar)

Arben Braho (Specialist)

Qëllimi i takimit

Zhvillimi i konsultimit publik me banorët lidhur me projektin për vendosjen e një stacioni bazë (antenë) të operatorit Vodafone në zonë, me qëllim përmirësimin e mbulimit të rrjetit celular dhe shërbimeve të komunikimit.

Zhvillimi i mbledhjes



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Z. Ramizi hapi takimin dhe prezantoi projektin për vendosjen e një stacioni bazë (antenë) të operatorit Vodafone, duke theksuar rëndësinë e përmirësimit të mbulimit të rrjetit në zonë.

Z. Beso: Ky projekt është kërkuar nga banorët, pasi ndër vite ka pasur probleme me mungesën ose dobësinë e sinjalit telefonik dhe internetit.

Z. Haki: Kemi një kërkesë për çakullimin e rrugës në fshatin Vërri pasi është bërë shumë keq dhe ka vështirësi në qarkullim.

Verion Alla pretendon për pronësinë e vendit ku do të vendoset antenna.

Përfundime:

Pas diskutimeve, banorët pjesëmarrës u shprehën në favor të projektit për vendosjen e antenës së operatorit Vodafone, duke kërkuar zbatimin e tij në përputhje me standardet teknike dhe ligjore.

Protokolli : Suela Mertkola

SEKRETARE E KËSHILLIT

Jona BOJKO





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 21/04/2026 **Ora :** 11:00

Vendi: Fshati Kalivaç (Njësia Administrative Trebinjë)

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 10 persona të pranishëm

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : “Për miratimin e dhënies me qira, për vendosjen e antenave të telefonisë të lëvishme në favor të kompanive One Albania SH.A në sipërfaqe, 160 M2 në pasurinë 665 ZK 2042 Kalivaç, Trebinjë dhe Vodafon Albania SH.A sipërfaqen 100 M2 në pasurinë 213/6 ZK 3753 Vërri Proptisht”

Pjesëmarrës :

Klajdi Gjona (Këshilltar)

Vjollca Pllaha (Këshilltare)

Besnik Xhyra (Këshilltar)

Arben Braho (Specialist)

Qëllimi i takimit

Zhvillimi i konsultimit publik me banorët e fshatit Kalivaç lidhur me projektin për vendosjen e një stacioni bazë (antenë) në zonë, me qëllim përmirësimin e mbulimit të rrjetit celular dhe shërbimeve të komunikimit.

Zhvillimi i mbledhjes

Z. Ermal Tole, përfaqësues nga Nj.A Trebinjë , hapi takimin dhe prezantoi projektin, duke shpjeguar vendndodhjen dhe rëndësinë e tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Z. Hato Sofi: Projekti duhet të realizohet, pasi zona ka probleme me sinjalin e telefonisë.

Z. Hekuran Hoxhollari(kryeplaku i fshatit): Jemi dakord me projektin dhe ndërtimin e antenës, nuk kemi kundërshtime .

Pjesëmarrës të tjerë: Rijam Collaku, Fiqiri Fezollari, shprehën dakordësi.

U diskutuan gjithashtu problematika të tjera si gjendja e rrugës për shkak të ndërhyrjeve të ujësjellësit, pagesat për kryepleqtë dhe mungesa e ndriçimit rrugor në disa fshatra.

Përfundime

Banorët pjesëmarrës u shprehën në favor të projektit për vendosjen e antenës, duke e konsideruar të nevojshme për përmirësimin e komunikimit. Gjithashtu u evidentuan probleme të tjera infrastrukturore që kërkojnë zgjidhje.

Protokolli : Suela Mertzola

Sekretare Këshilli

Jona Bojko

